

Data 25.02.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE TONERA” - Mallra - MARRËVESHJE KUADËR ME DISA OPERATORË EKONOMIKË - KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA - ME RIHAPJE KONKURRIMI PAS LIDHJES SË MARRËVESHJES KUADËR.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Toner per printer lazer /makina fax - 30125110-5

Toner për makinat fotokopjuese - 30125120-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 179,137,037 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe **1,809,647.81** (një milion e tetëqind e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë pikë tetëdhjetë e një) **Euro pa TVSH.**

Vlerat në këto dokumente tenderi janë konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 25.02.2025, me kurs këmbimi 98.99 (nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e organit qendror blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të

xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet,*

autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2.3.4 Operatorët ekonomikë ofertues që ofrojnë artikujt objekt prokurimi (tonerat) duhet të dorëzojnë: Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuar, i cili duhet të përmbajë informacionin e plotë të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emri, kontakti telefonik, adresa e email-it dhe website-i zyrtar).

Shënim: Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm për kualifikim është hartuar në përputhje me pikën 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me pikën 8 të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ka lidhje dhe është proporcional me objektin e prokurimit si dhe është në përputhje me pikën 12 të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, Nr. 7998 prot., datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin e tij, Nr. 814, Datë 02.09.2021 “Për disa rekomandime Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt blerje tonera/bojra” ka vendosur: “...T’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimeve Publike që: 1. Të udhëzojë autoritetet kontraktore të mos vendosin kriterë përjashtues në DST si autorizimin e prodhuesit/distributorit, duke krijuar barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojra. 2. Të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në lidhje me barrierat rregulluese të konkurrencës të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrative në tregun e prokurimeve publike me objekt blerje tonera/bojra....” Në zbatim edhe të vendimit Nr. 814, Datë 02.09.2021, të Autoritetit të Konkurrencës, në pikën 12 të Rekomandimit Nr. 7998 prot., datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, Agjencia e Prokurimit Publik ka rekomanduar autoritetet kontraktore, ku shprehimisht citohet: “...12. Gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit, APP ka konstatuar raste kur AK u referohen në mënyrë direkte apo indirekte, të specifikimet teknike, apo të kërkesat për kualifikim, markave apo origjinave specifike për produktet apo shërbimet e kërkuara. Njëkohësisht, në procedura të ndryshme prokurimi dhe sidomos në procedurat me objekt blerje tonerash, autoritetet/entet kontraktore kërkojnë që operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi, duke vërtetuar lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për pajisjen me markën konkrete të përcaktuar, kërkesë e cila mund të kufizojë pjesëmarrjen dhe vendos në kushte të pabarabarta konkurruese operatorët ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor duhet të vlerësojë rast pas rasti përcaktimin e kriterëve kualifikuesë, mbështetur në analiza konkrete të nevojave për mallra, punë apo shërbime dhe mundësisë që ka tregu për plotësimin e tyre dhe këto kriterë në asnjë rast nuk duhet të jenë përjashtuesë, duke kufizuar numrin e operatorëve ekonomikë. Sjellim në vëmendje që këto rekomandime vinë si rrjedhojë edhe e Vendimit nr.814, datë 02.09.2021 dhe Vendimit m. 851, datë 03.12.2021, të Autoritetit të Konkurrencës....”

Në analizë të rekomandimit të mësipërm të APP-së, kriteri për kualifikim, është në përputhje me këtë rekomandim pasi: APP-ja ka konstatuar se, në procedura të ndryshme prokurimi dhe sidomos në procedurat me objekt blerje tonerash, autoritetet/entet kontraktore kërkojnë që operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi, **duke vërtetuar lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për pajisjen me markën konkrete të përcaktuar**, dhe në rastin konkret kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit apo të distributorit të autorizuar nuk është kufizuese dhe nuk i vendos operatorët ekonomikë në kushte të pabarabarta pasi, **tonerat janë kërkuar të jenë origjinale ose ekuivalente**, pra pranohen edhe tonera ekuivalente, pra kompatibël. Pra tonerat objekt i kësaj procedure prokurimi nuk janë kërkuar të jenë origjinale të prodhuesve të pajisjeve ku do të vendosen këto tonera (sikurse është rasti i analizuar nga APP në këtë rekomandim), por janë kërkuar të jenë tonera origjinale ose ekuivalente që do të thotë, tonera të prodhuar nga prodhues të ndryshëm nga prodhuesi i markës së pajisjeve për të cilat kërkohej këto tonera dhe prodhues të tillë në treg ka shumë. Gjithashtu, referuar kriterit për kualifikim operatorët ekonomikë mund të paraqesin edhe autorizim nga distributorët, kërkesë e cila e zgjeron pjesmarrjen pasi, të tillë për cdo lloj pajisje janë në një numër të madh jo vetëm në rajon por edhe në tregun shqiptar. Një fakt i tillë është verifikuar nga ana e autoriteti kontraktor gjatë testimit të tregut për këtë objekt prokurimi, ku ka rezultuar se kanë paraqitur ofertat e tyre të cmimeve shumë operatorë ekonomikë, të cilëve u ishin dërguar edhe specifikimet teknike të tonerave.

Përsa kohë që tonerat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor nuk janë vetëm tonera origjinale, të prodhuesit të pajisjeve, por pranohen edhe tonera “ekuivalente”, pra tonera kompatibël, kërkesa për autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributor, nuk e kufizon pjesmarrjen dhe është një kriter i cili garanton AK-në se operatorët ekonomikë pjesmarrës kanë kapacitetet, dhe aftësitë për të siguruar brenda afatit të kërkuar nga autoritetet kontraktore të përfshira në këtë procedurë prokurimi, tonera të cilët plotësojnë kërkesat e tyre, pra të jenë origjinale ose ekuivalente, me vullë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara. Tonerat janë produkte importi, pra që nuk prodhohen në vend dhe është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë aftësitë, marrëveshje me prodhues ose me distributorët e tyre për të siguruar në kohë plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, pasi kjo procedurë prokurimi, realizohet nëprmejt marrëveshjes kuadër me fat 2 vite, për të gjitha autoritetet kontraktore subjekte të VKM Nr. 531, datë 07.09.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **3 (tre) mjete ATP për transportin e mallrave** objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qera/huapërdorje

- Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qera/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.
- Për mjetin në pronësi/qera/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracioni i detyrueshëm i mjetit (i vlefshëm).

Shënim: Kriteri Nr.2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten nga OE te sukseshem ne MK, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi dhe vendndodhjen gjeografike të autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.6 Operatori ekonomik, për të realizuar shërbimin e transportit me qëllim shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në destinacion, duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës , si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	3
Punëtor i thjeshte	3
Total	6

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Lejen përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)

Shënim: Në lidhje me kërkesën që OE duhet të disponojë 3 (tre) persona me profesionin shofer që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe 3 (tre) punëtorë të thjeshtë, duhet të jenë të regjistruar në listpagesat e shoqërisë dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Kriteri Nr. 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten nga OE te sukseshem ne MK, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjës, përkatësisht shofer dhe punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, Në lidhje me kërkesën që OE duhet të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe 1(një) punëtor të thjeshtë, duhet të jenë të regjistruar në listpagesat e shoqërisë dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës. Për këto arsye, njësia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e nevojshme, proporcionale dhe është e mjaftueshme për t’i shërbyer synimit.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët ose skedat teknike të prodhuesit për të gjithë artikujt objekt prokurimi për të cilët nuk janë kërkuar mostra. Katalogu / ose skeda teknike duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.*

Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit.

Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të

mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, mostrën për artikujt me nr. rendor **14, 30, 256, 778, 840, 921, 986, 1024, 1091, 1098, 1108, 1149, 1172, 1177, 1212** (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”)

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: Mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).
- Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave, duke marrë në konsideratë vlerën e tyre, si dhe me qëllim verifikimin e specifikimeve teknike që ka secili artikull objekt prokurimi, duke krijuar kështu bindjen për ofrimin e artikujve që përmbushin kërkesat e DST. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit me artikujt e ofruara nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresat përkatëse të autoriteteve kontraktore përfituese, sipas përcaktimeve në këto dokumente tenderit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër **zëvendësimin e çdo toneri** që mund të ketë defekt fabrike ose që nuk përshtatet me pajisjen printer/fotokopje në Autoritetet Kontraktore përfituese.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** ku të deklarojë se tonerat do të jenë origjinale ose ekuivalente me to, do të jenë me pullë sigurie, do të jenë të reja, nuk do të

jenë të rimbushura, nuk do të jenë të ricikluara, nuk do të jenë të riprodhuara, do të jenë të paketuara dhe të pahapura.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** garancie ku të deklarojë se artikujt e ofruar do të kenë jo më pak se 1 (një) vit garanci nga data e furnizimit të mallit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se objekti i prokurimit do të realizohet në kohë dhe cilësi dhe në vendet e caktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese. Në vendosjen e këtyre kriterëve organi qendror blerës ka në vëmendje zbatimin e kontratës, në cilësinë e fazës më të rëndësishme të ciklit të prokurimit. Me përcaktimin e kërkesave si më sipër synohet ofertimi nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët do të furnizojnë autoritetet kontraktore përfituese me mallra konform specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjatë përmbushjes së detyrimeve kontraktore kundrejt autoriteteve kontraktore përfituese, operatorët ekonomikë duhet të realizojnë objektin e prokurimit në cilësinë dhe parametrat e deklaruar përmes deklaratave të mësipërme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar nga organi qendror blerës dhe autoritetet kontraktore përfituese, sipas kërkesave për prokurim të përqendruar të këtyre të fundit deri në publikimin e njoftimit të kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u bazuar në katalogun e unifikuar në fuqi (2024) për tonerat e pajisjeve të printimit / fotokopjimit, miratuar me urdhrin nr. 142, datë 10.09.2024, si dhe kërkesat e vetë AK përfituese, administruar deri në publikimin e njoftimit të kontratës, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njesisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në

sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: